

Deri te:
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
-për ministren znj. Frosina Tashevska Remenski
Shkup

LËNDA: Raport i veçantë për gjendjen në Qendrën e Përkohshme Transit për Migrantë “Vinojug” dhe Qendrën e Përkohshme Transit “Tabanoc”

Avokati i Popullit – si mbrojtës i të drejtave të qytetarëve, dhe si Mekanizëm Parandalues Nacional, në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 60/03 dhe 114/09), krahas kompetencave të tjera, ka autorizim t’i monitorojë gjendjet sa i përket respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat kufizohet lëvizja e lirë.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit realizoi disa vizita, përkatësisht zbatoi monitorimin e kushteve të pranimit dhe trajtimit të migrantëve dhe refugjatëve në Qendrën e Përkohshme Transit për Migrantë “Vinojug” dhe Qendrën e Përkohshme Transit “Tabanoc” në kufirin me Republikën e Serbisë.

Vizitat u zbatuan konform kompetencave të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe në përputhje me mandatin e Mekanizmit Parandalues Nacional të përcaktuara në Protokollin Fakultativ Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe formave të tjera të trajtimit johuman dhe përçmues.

Qëllimi i vizitave është që, përmes inspektimit të kushteve materiale në këto qendra për strehimin e përkohshëm të migrantëve dhe refugjatëve dhe trajtimin e kësaj kategorie të personave, të perceptohet realizimi i të drejtave të tyre të garantuara me ligjet nacionale dhe aktet ndërkombëtare, veçanërisht me Konventën e Gjenevës për

Statusin e Refugjatëve të vitit 1951 dhe të identifikohen rreziqet me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues dhe ndëshkues.

Njëkohësisht, me vizitat e përbashkëta me ombudsmanët e shteteve të rajonit, u mundësua shkëmbimi i përvojave, sa i përket mënyrës së pranimit dhe trajtimit të migrantëve dhe refugjatëve në vendet e tjera të cilët janë në e rutën e udhëtimit transit, dhe përforcimi i bashkëpunimit të institucioneve të ombudsmanëve lidhur me çështjen e migrantëve dhe refugjatëve.

Me qëllim të realizimit të qëllimit, ekipi i Avokatit të Popullit zbatoi inspektim mbi kushtet materiale dhe kapacitetet e vendosjes, zhvilloi biseda me personat përgjegjës të Qendrave dhe realizoi takim të drejtpërdrejt me migrantët dhe refugjatët të cilët, në momentin e vizitës, ishin pranuar dhe vendosur.

Ky Raport i përmban informatat dhe pikëpamjet për gjendjet e konstatuara nga vizitat e realizuara, si dhe rekomandimet dhe sugjerimet e Avokatit të Popullit për tejkalimin dhe përmirësimin e gjendjeve negative.

QENDRA E PËRKOHSHME TRANSIT PËR MIGRANTË “VINOJUG”

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional, bashkë me UNHCR, më datë 15.09.2015, e realizoi vizitën e parë në Qendrën e Përkohshme Transit për Migrantë “Vinojug”, në Gjevgjeli, ndërsa pas kësaj vizite pasuan edhe tri vizita të tjera, edhe atë:

- më datë 17.11 2015, u realizua vizitë e përbashkët në Qendrën Transit nga ana e ekipit të Avokatit të Popullit si mbrojtës i të drejtave të qytetarëve dhe si Mekanizëm Parandalues Nacional të udhëhequr nga Zëvendësja e Avokatit të Popullit Vaska Bajramovska Mustafa dhe ushtruesi i detyrës Ombudsman i Republikës së Greqisë, Vasilis Karidas,

- më datë 30.11 2015, Avokati i Popullit, z. Ixhet Memeti, bashkë me Ombudsmanen e Austrisë, znj. Gertrude Brinek dhe Shefin e Zyrës së UNHCR, z. Mohamed Arif realizuan vizitë në Qendrën Transit “Vinojug”, dhe

- më datë 10.12 2015, u realizua vizitë në Qendrën Transit “Vinojug” nga ana e ekipit të Avokatit të Popullit si mbrojtës i të drejtave të qytetarëve dhe Mekanizmit Parandalues Nacional të udhëhequr nga Zëvendësja e Avokatit të Popullit, znj. Vaska Bajramovska Mustafa, me Ombudsmanin për Fëmijë të Holandës i cili kryeson me Rrjetin Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë-ENOK dhe me përfaqësuesit e SOS Fshatit për Fëmijë në Maqedoni dhe SOS Fshatit për Fëmijë në Holandë.

Menaxhimi me Qendrën e Përkohshme Transit “Vinojug”

Avokati i Popullit – MPN, gjatë vizitave zhvilloi biseda me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme-Qendra Rajonale për Çështje Kufitare Jug, përkatësisht me drejtorin e Qendrës së Përkohshme Transit dhe zëvendësin e tij, me drejtorin e Qendrës për Menaxhim me Kriza dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, me përfaqësuesit e UNHCR dhe me Kryqin e Kuq të RM-së.

Sa i përket çështjes lidhur me procedurat e organizimit të pranimit të migrantëve dhe institucioneve e organeve kompetente për organizimin e pranimit, regjistrimit dhe trajtimit të migrantëve janë marrë informata se jo vetëm që nuk janë miratuar Procedurat Standarde Operative, sipas të cilave do të zhvilloheshin aktivitetet e Qendrës, por nuk është përcaktuar qartë se kush e drejton Qendrën Pranimit, përkatësisht a është ajo nën kompetencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe sektorit joqeveritar, apo Qendra është nën drejtimin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Qendrës për Menaxhimin me Kriza.

Kushtet e vendosjes në Qendrën e Përkohshme Transit “Vinojug”

Nga vizitat e realizuara, Avokati i Popullit konstatoi se migrantët të cilët vijnë përmes kalimit kufitar ilegal me Republikën e Greqisë (kuota 59) mbërrijnë në këmbë deri në Qendrën e Përkohshme Transit “Vinojug”, e cila është në distancë prej rreth një kilometër. Rruga nga kalimi kufitar deri në Qendër është parrafshët, nuk është e

ndriçuar dhe është e vështirë për bartjen e personave në karroca invalidore. Higjiena nuk është siguruar, përveç dy kontejnerëve të cilët janë vendosur kohë më parë, nuk ka kosha për plehra, rreth e qark vërehen lloje mbeturinash nga më të ndryshmet dhe hapësira ngjan në një vendgrumbullim të madh.

Në lidhje me këtë problem, janë pranuar informata se askush nuk ka mjete për pastrimin e mbeturinave dhe se vetëqeverisja lokale ka kërkuar por, nga pushteti qendror, nuk ka marrë mjete për këtë dedikim.

Më tutje, është konstatuar se migrantën në Qendrën “Vinojug” hyjnë në grupe prej 50 personash, ndërkaq nëse ka fluks më të madh të migrantëve, atëherë të njëjtët nga shumë orë presin para gardhit të Qendrës dhe u ekspozohen kushteve të pavolitshme klimatike. Kohëve të fundit është vendosur një tendë me qëllim të vendosjes së migrantëve përderisa presin të futen në Qendër, por e njëjta nuk mund t'i pranojë të gjithë migrantët. Tri tenda janë vendosur jashtë gardhit, mirëpo, ato për shkaqe të panjohura, ende nuk janë vënë në funksion.

Avokati i Popullit - MPN gjatë vizitës së realizuar më datë 17.11.2015, vërejt një grup më të madh të migrantëve ekonomik të cilët nuk ishin lëshuar të futeshin në Qendrën Tansit për shkak të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që të mos lëshohen migrantë të cilën nuk vijnë nga vende të përfshira me luftë. Këta persona u kthyen në territorin grek, pa iu mundësuar fillimi i procedurës për paraqitjen e kërkesës për azil.

Nga ana e organizatave joqeveritare dhe nga ana e UNHCR-së dhe Kryqit të kuq në hyrje të kampit, migrantëve u ndahet ushqim, ujë, materiale higjienike dhe sipas nevojave batanije, ndërsa racione të ngrohta ende nuk janë siguruar, për shkak se nuk është siguruar pajisja përkatëse.

Përndryshe, në terren janë të pranishëm vullnetarë nga më shumë organizata joqeveritare, në mesin e të cilave: Shoqata e Juristëve të Rinj. “Legis”, “La Strada”. Pastaj, migrantët dhe refugjatët futen në tendë ku u mblidhen dokumentet të cilat u dorëzohen personave zyrtarë të MPB me qëllim që të bëhet regjistrimi i tyre.

Në Qendrën e Përkohshme Transit “Vinojug” janë vendosur më shumë objekte të montuara në të cilat është vendosur stacioni policor për kontroll kufitar, ndërsa në katër kontejnerë kryhet evidentimi kompjuterik i migrantëve. Për këtë qëllim janë angazhuar

persona nga organizata joqeveritare Shoqata e Juristëve të Rinj, të cilët e kryejnë punën teknike të regjistrimit dhe të cilët punojnë në tre turne.

Procedura e evidentimit bëhet nga ana e personit zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa regjistrimi kryhet sipas dokumenteve të lëshuara nga pala greke, përkatësisht regjistrimit të të dhënave në sistemin kompjuterik, me këtë rast nuk merren shenjat e gishtërinjve dhe nuk bëhet fotografimi i personave.

Kontrolli i bagazhit, të cilin e kanë me vete migrantët, bëhet vetëm gjatë hyrjes në kamp, ndërsa sipas Avokatit të Popullit kjo nuk është e mjaftueshme sepse vetëm disa orë në ditë është në funksion skeneri. Me mënyrën e këtillë të kontrollit të bagazhit dhe të njerëzve nuk mund të garantohet siguria.

Migrantët, pastaj vendosen në tenda për të pushuar. Për momentin në funksion janë katër tenda të mëdha, në të cilat mund të përkujdeset një numër i madh i migrantëve.

Nga ana e UNICEF janë siguruar dy tenda të dedikuara për fëmijët dhe nënat, në të cilat përveç se mund të pushojnë, fëmijët kanë mundësi edhe të argëtohen. Nga ana e UNICEF-it janë siguruar rekuizite dhe lodra të ndryshme për fëmijë të moshave të ndryshme me qëllim që, derisa e presin transportin, më lehtë dhe në mënyrë më të organizuar ta kalojnë kohën.

Përveç objekteve të tjera në Qendrën e Transitit janë vendosur toalete dhe dushe të montuara, kështu që janë siguruar kushte për higjienë elementare.

Avokati i Popullit - MPN gjatë vizitës së fundit konstatoi se nga vizita e parë, prej para katër muajsh, është bërë pak sa i përket rregullimit dhe përshtatjes së qendrës transit për pranimin e personave në kushte të dimrit. Përkatësisht, edhe më tej në kamp nuk është zgjidhur çështja e sigurimit të energjisë elektrike, përkatësisht nuk janë vendosur transformatorë, nuk ka ngrohje nëpër tenda për të rritur dhe fëmijë as në objektet e tjera të montuara, e as nuk është siguruar uji i nxehtë. Trupat ngrohës me gaz, me të cilët në ndërkohë është furnizuar qendra nuk mund të sigurojnë ngrohje të plotë të objekteve të montuara në të cilët janë vendosur refugjatët dhe migrantët. Në pyetjen se kur do të vendosen transformatorët, nuk është dhënë përgjigje konkrete.

Ndihma juridike

Ndihma juridike e migrantëve në Qendrën e Transitit, sipas të dhënave të personave zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme është siguruar nga organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare. Avokati i Popullit - MPN u informua se nga UNHCR dhe Shoqata e Juristëve të Rinj MILA, vazhdimisht ka persona të angazhuar të cilët ofrojnë ndihmë juridike falas me kërkesë të migrantëve.

Gjatë ditëve kur migrantët ekonomikë nuk lëshoheshin ta vazhdonin rrugën drejt kufirit me Republikën e Serbisë, këtyre personave u është sqaruar procedura për paraqitjen e kërkesës për azil, por nuk u është dhënë mundësia ta fillojnë procedurën, meqë nga ana e policisë kufitare janë kthyer në territorin grek.

Numri i migrantëve të cilët regjistrohen në Qendër është i ndryshueshëm, kështu që nëse gjatë muajve të parë ishte regjistruar hyrja e 2000-3000 migrantëve në muaj, më pas numri i tyre sa vinte e rritej. Gjatë vizitës së realizuar më datë 17.11 2015, Avokati i Popullit - MPN, u informua se brenda 24 orëve ishin regjistruar 6 780 migrantë, por disa ditë më parë numri i tyre kishte arritur deri në 10 000 migrantë.

Të dhënat më të reja tregojnë se nga data 19 korrik, kur ka filluar regjistrimi i migrantëve, në përputhje me Ligjin për ndryshime të Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme, deri më datë 13.12.2015, 44% e personave të regjistruar janë gra dhe fëmijë, prej të cilëve 28% janë fëmijë. Njëkohësisht, është pranuar e dhëna se 17 856 fëmijë të moshës nga 16-18 vjeç udhëtojnë pa prindër, e që paraqet edhe një nga kushtet e mundshme për keqpërdorimin e tyre në procesin e trafikimit me qenie njerëzore.

Të dhënat e pranuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale tregojnë se më datë 09.12 2015, në Qendër janë regjistruar 1835 persona, nga të cilët 641 janë persona të mitur, 382 gra dhe 812 meshkuj. Po atë ditë, janë regjistruar 39 fëmijë të pashoqëruar, ndërsa është pranuar informata se gjatë ditës mesatarisht regjistrohen 200 fëmijë, për të cilët dyshohet se janë pa shoqërim prindëror.

Në këto raste zhvillohet bisedë me personat të cilët prezantohet si anëtarë të familjes së ngushtë, bëhet kontrolli në evidencën e dërguar nga pala greke dhe në të shumtën e rasteve lejohet ta vazhdojnë udhëtimin. Së këtejmi, në rast se fëmija është krejtësisht i vetëm kontaktohet punonjësi social i Ministrisë së Punës dhe Politikës

Sociale dhe nëse konstatohet se udhëton pa kurrfarë shoqërimi dërgohet në Qendrën për Azilkërkues në Vizbeg, ose në shtëpinë e sigurt në Kozle.

Spektori joqeveritar dhe UNHCR kanë siguruar përkthyes, të cilës sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit nuk janë në numër të mjaftueshëm.

Mbrojtja shëndetësore

Mbrojtja shëndetësore në Qendër është organizuar përmes shëndetit publik dhe është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Avokati i Popullit konstatoi se mbrojtja shëndetësore është organizuar me vendosjen e Ambulancës e cila funksionon 24 orë dhe ka kujdestari të përhershme të punonjësve shëndetësorë (mjek-specialist të mjekësisë së përgjithshme dhe infermiere).

Ambulanca, në të cilën pranohen pacientët të cilët kanë nevojë për mbrojtje shëndetësore, përbëhet nga dy hapësira të montuara. Në njërin kryhen intervenime shëndetësore, ndërsa në tjetrën ka tre krevate të cilët janë dedikuar për pushim dhe rianimacion të pacientëve.

Nga biseda me personelin mjekësor rezulton se në të shumtën e rasteve, pacientët ankohen për infeksione respiratore, diare, ngritje të temperaturës, alergji dhe pickime nga insekte, lodhje dhe rraskapitje nga rruga e gjatë dhe ndikimi i kushteve klimatike. Nëse pacientët kanë nevojë për tableta ata mund të furnizohen edhe nga Ambulanca por edhe nga Kryqi i Kuq i RM-së, por në rastet kur ka nevojë për intervenim më serioz, shëndeti publik ka siguruar autoambulancë për ndihëm e parë me të cilën pacientët dërgohen në shtëpitë shëndetësore më të afërta.

Gjatë vizitës së fundit, të datës 10.12 2015, Avokati i Popullit pranoi informatë se në 24 orët e fundit ekipi mjekësor ka kryer 10 kontrolle të pacientëve, nga të cilët 7 kanë qenë fëmijë, ndërsa 3 kanë qenë raste më serioze dhe janë transferuar në shtëpinë shëndetësore më të afërt.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit u konstatua se i njëjti mbahet me rregull nga ana e personelit mjekësor.

Transporti i migrantëve dhe refugjatëve

Transporti i migrantëve bëhet në mënyrë të organizuar, përkatësisht me komunikacion hekurudhor, autobusë dhe taksi. Nuk mund të parashikohet numri i migrantëve të cilët për çdo ditë arrijnë, sepse numri ndryshon përditë. Biletat për komunikacionin hekurudhor lëshohen para se të hyjnë në tre, bileta është e vlefshme 24 orë, ndërsa fëmijët deri në 10 vjet nuk paguajnë biletë.

Gjatë vizitës së kryer, më datë 10.12.2015, Avokati i Popullit hasi një gjendje kaotike në Qendrën e Pranimit. U vërejt se biletaria hapet para se të mbërrijë treni dhe se krijohet një rrëmujë dhe turmë gjatë blerjes së biletave. Hapësira para hyrjes së trenit nuk është e mbuluar, kështu që migrantët u ekspozohen kushteve të këqija klimatike në shi dhe borë. Gjithashtu, nuk bëhet seleksionimi dhe nuk u jepet përparësi fëmijëve, grave dhe personave me invaliditet, kështu që ekipi i Avokatit të Popullit ishte dëshmitar kur disa persona u luteshin përfaqësuesve të UNHCR t'i bartnin deri te treni.

Duke e pasur parasysh se çmimi i caktuar prej 25 euro është disa herë më i lartë sesa çmimi i përcaktuar për qytetarët vendas, Avokati i Popullit qysh në datën 09.10.2015 hapi procedurë gjatë së cilës konstatoi trajtim të pabarabartë të të huajve me shtetasit maqedonas dhe qasje të pabarabartë deri te shërbimet në raport me çmimin e biletës, si dhe mosrespektim të rregullave fiskale.

Duke e pasur parasysh parimin e mosdiskriminimit, Avokati i Popullit i drejtoi Rekomandim Qeverisë së Maqedonisë dhe ndërmarrjes publike, që çmimet e biletave për shtetasit e huaj të barazohen me ato të qytetarëve të Republikës dhe kërkoi kategorizimin e biletave për fëmijët mbi 10 vjet dhe për persona invalid. Qeveria, në vend të që ndërmerr masa konkrete u përgjigj se do të veprojë në përputhje me kompetencat, kështu që akoma nuk ka dërguar përgjigje konkrete.

Avokati i Popullit - MPN, gjithashtu konstatoi se migrantët nuk mund të zgjedhin se me çfarë mjeti transportues do ta vazhdojnë rrugëtimin drejt Tabanocit, ndërsa si pasojë e kësaj shpeshherë me orë të tëra e presin trenin (pa iu dhënë mundësia e shfrytëzimit të ndonjë lloji tjetër të transportit) dhe të transferohen deri në destinacionin e radhës. Gjendja e këtillë u has edhe gjatë vizitës së fundit, kur migrantët u ankuan se

me orë të tëra e presin mbërritjen e trenit. Në pyetjen se kush e përcakton se me çfarë mjete do të transportohen migrantët dhe refugjatët, Avokati i Popullit nuk mori përgjigje konkrete.

Gjatë vizitës së realizuar, më datë 10.12.2015, ekipi i Avokatit të Popullit – MPN vërejtë se një grup më i madh i migrantëve dhe refugjatëve ishin nisur/lënë vetë t'i gjejnë autobusët e stacionuar dhe automjetet e taksive. Kështu që më vonë, arriti informata se një grup i caktuar e kishte humbur rrugën gjatë orëve të natës dhe për një kohë më të gjatë nuk kishin mundur ta gjenin vendin se ku stacionohen autobusët dhe automjetet e taksive.

Biseda me migrantët

Gjatë vizitave të realizuara, Avokati i Popullit – MPN, zhvilloi biseda me më shumë migrantë dhe refugjatë. Migrantët, kryesisht nuk kishin ankesa sa i përket trajtimit nga ana e nëpunësve policorë dhe shprehën mirënjohje për ndihmën e cila u ofrohet në formë të ushqimit, ujit, lëngjeve, materialeve higjienike, të cilën ua shpërndajnë organizatat joqeveritare.

Migrantët u ankuan lidhur me pritjet e gjata të transportit drejt pikës kufitare Tabanoc dhe kundërshtonin lidhur me moslejimin e daljes nga Qendra Transitore. Sa i përket asaj se a u është sqaruar procedura juridike dhe a u është ofruar ndihma juridike, ata cekën se këtë ndihmë e pranojnë nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare edhe atë vetëm me kërkesë të tyre.

Nga bisedat e zhvilluara rezulton se qëllimi i vetëm i tyre është të kalojnë transit përmes Republikës së Maqedonisë dhe të vazhdojnë rrugën drejt vendeve të Evropës Perëndimore. Migrantët, në Qendrën e Transitit qëndrojnë disa orë, varësisht se si organizohet transporti i tyre i mëtutjeshëm. Gjithashtu, u ankuan se nuk u lejohet të bëjnë përzgjedhjen e transportit me të cilin do ta vazhdonin rrugëtimin drejt kufirit me R. të Serbisë.

Megjithatë, gjatë vizitës së realizuar, më datë 10.12.2015, Avokati i Popullit – MPN ishte dëshmitarë i ankesave nga një pjesë e migrantëve lidhur me sjelljen e policisë gjatë pranimit në Qendrën e Përkohshme të Transitit, me ç'rast cekën se nga

ana e nëpunësve policorë janë shtyrë dhe se është përdorur forca në mënyrë që të radhiten në grup.

Më së shumti ankesa u pranuan sa i përket ngrohjes, sepse nuk është zgjidhur problemi me sigurimin e energjisë elektrike, përkatësisht ende nuk janë instaluar transformatorët.

QENDRA E PËRKOHSHME TRANSITE – “TABANOC”

Vizita e parë e Qendrës Transite “Tabanoc” nga ana e Avokatit të Popullit si mbrojtës si të drejtave të qytetarëve dhe si Mekanizëm Parandalues Nacional, u realizua në datën 14.09. 2015 bashkë me përfaqësuesit e UNHCR.

Në datën 07.12.2015, Avokati i Popullit, bashkë me Mbrojtësin e Qytetarëve të Republikës së Serbisë, z. Sasha Jankoviq, realizuan vizitë në Qendrën Transit “Tabanoc” dhe në kampet e pranimit në R. të Serbisë.

Ekipi i Avokatit të Popullit-Mekanizëm Parandalues Nacional, realizoi vizitë në Qendrën Transite “Tabanoc” edhe në datën 10.12.2015.

Menaxhimi dhe organizimi i Qendrës Transit “Tabanoc”

Me Qendrën Transit “Tabanoc” administron Qendra për Menaxhimin me Kriza. Nga disa vizita të cilat i realizoi Avokati i Popullit në këtë Qendër, u konstatua organizim i mirë i kampit, ndërsa gjatë çdo vizite të ardhshme vërehet përmirësim i kushteve.

Në pikën kufitare “Tabanoc” në një objekt të montuar është vendosur Stacioni policor për kontroll kufitar, ndërsa nëpunësit policorë janë siguruar nga stacioni policor i Tabanocit. Migrantët dhe refugjatët në Qendër arrijnë me trena, autobusë dhe automjete taksi. Janë të rralla rastet e regjistrimeve të migrantëve, të cilët nuk janë evidentuar në Qendrën Transite “Vinojug” në Gjevgjeli.

Gjatë pranimit të tyre vazhdimisht janë të pranishme ekipet e UNHCR, Kryqit të Kuq, vizita të kohëpaskohshme bëhen edhe nga UNICEF-i. Në terren, gjithashtu janë të pranishme më shumë organizata joqeveritare, në mesin e të cilave dhe OJQ Legis, OJQ Vëllazërimi nga Kumanova, La Strada, Shoqata e Juristëve të Rinj, etj.

Kushtet e vendosjes në Qendrën Transit “Tabanoc”

Në Qendrën Transit “Tabanoc”, kushtet e pranimit të fëmijëve dhe refugjatëve janë më të mira sesa në Qendrën e Pranimit “Vinojug”. Qëndrimi i migrantëve në pikën kufitare Tabanoc është shumë i shkurtër, duke e pasur parasysh se kufiri i R. të Serbisë është në distancë prej vetëm disa qindra metra. Pas mbërritjes, aktivistët humanitarë u shpërndajnë ushqim, ujë, lëngje dhe material higjienik.

Në Qendrën e Pranimit nga UNHCR janë siguruar hapësira të montuara, në të cilat ruhet ushqimi, uji, materialet për higjienë dhe batanijet, e siguruar nga sektori joqeveritar dhe organizatat ndërkombëtare dhe të cilat u shpërndahen migrantëve, përkatësisht refugjatëve. Në një pjesë të objekteve janë vendosur personat të cilët kanë nevojë për pushim dhe për këtë qëllim UNHCR ka ngritur një tendë të madhe. Janë vendosur toalete të montuara, si dhe është instaluar uji, kështu që janë siguruar kushtet elementare për mirëmbajtjen e higjienës, me atë se është konstatuar se edhe në këtë Qendër ka mungesë të ujit të ngrohtë.

Ekipi i Avokatit të Popullit zbatoi inspektim në hapësirat e Fshatit për Fëmijë SOS, i cili ka vendosur objekt montazh në dy kate, e që është dedikuar për qëndrimin e fëmijëve dhe nënave. Në këtë objekt përkujdesen fëmijët për periudhë të shkurtër kohore në kushte relativisht të mira, sepse objekti ka ngrohje dhe është i pajisur me materialet e domosdoshme dhe me ushqim për fëmijët e të gjitha moshave. Avokati i Popullit – MPN ka vërejtje sa i përket mungesës së ujit të nxehtë, i cili është i domosdoshëm për mirëmbajtjen e higjienës, si dhe mungesës së specialistit – pediatër. Fshati për Fëmijë, për migrantët dhe refugjatët, ka siguruar internet falas.

Gjatë vizitës, Avokati i Popullit – MPN, konstatoi se është siguruar racion i nxehtë, supë e nxehtë, veshje dhe këpucë për migrantët, është siguruar një hapësirë

(tendë) nga ana e organizatës joqeveritare La Strada, për strehimin e fëmijëve dhe nënave, e cila ishte mjaftueshëm e ngrohtë. Kjo organizatë, gjithashtu, ofron edhe ndihmë juridike dhe psikosociale, si dhe mbrojtje për nënat dhe fëmijët.

Gjatë vizitës së realizuar, më datë 07.12 2015, Avokati i Popullit bashkë me Mbrojtësin e të Drejtave të R. të Serbisë, e përshkuan rrugën deri në pikën kufitare me R. të Serbisë.

Me këtë rast, Avokati i Popullit konstatoi se rruga nëpër të cilën lëvizin migrantët është e parrafshët dhe me baltë, pa ndriçim dhe mbrojtje në shinat e hekurudhës, kështu që fëmijët, gratë dhe personat invalidë lëvizin me vështirësi nëpër të. Por, u vërejt se është siguruar automjet me të cilin barten personat e pamundur deri në pikën kufitare. Duke e pasur parasysh se, po atë ditë, u vizitua edhe kampi për pranimin e refugjatëve në fshatin Miratoc, i cili gjendet në R. të Serbisë, u konstatua se migrantët duhet të kalojnë nga dy kilometra e gjysmë rrugë, nëpër terren të parrafshët nga njëra qendër e pranimit në tjetrën, e që sipas Avokatit të Popullit është johumane, veçanërisht nëse kemi parasysh se rrugën e njëjtë duhet ta përshkojnë fëmijët e vegjël, gratë ose personat invalid.

Vetëm disa ditë më vonë, më saktësisht më datë 10.12 2015, ekipi i Avokatit të Popullit dhe Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi aktivitete të përshpejtuara në Qendrën Transit “Tabanoc”. Përkatësisht, traseja deri në pikën kufitare ishte mbuluar me zhavorr të imët, nga njëra anë ishte rrethuar me gardh, ndërsa gjatë bisedës me drejtorin e Qendrës së Pranimit u informuam se për disa ditë traseja do të ndriçohet dhe përshtatet për lëvizje më të lehtë. Gjithashtu, punohej me intensitet të madh në ngritjen e tri tendave të mëdha të dedikuara për qëndrimin e migrantëve dhe refugjatëve, me dysheme me shtresa të veçanta dhe ngrohje, ndërkohë që realizoheshin edhe punime të tjera ndërtimore. Përgatitej terren për ngritjen e tendave për persona me nevoja të veçanta, toalete të montuara dhe objekte administrative. Avokati i Popullit u siguria personalisht se në këtë Qendër punohet për çdo ditë në drejtim të përmirësimit të kushteve.

Mbrojtja shëndetësore

Mbrojtja shëndetësore në Qendrën “Tabanoc”, organizohet nga ana e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Janë siguruar kujdestari të ekipeve mjekësore me qëllim të ofrimit të mbrojtjes primare shëndetësore për migrantët dhe refugjatët. Rastet më të rënda drejtohen në Shtëpinë e Shëndetit në Kumanovë, ndërsa sipas nevojës edhe në klinikat e Shkupit.

Në të shumtën e rasteve, pacientët ankohen për infeksione respiratore, temperaturë të ngritur, alergji, lodhje dhe rraskapitje për shkak të udhëtimit të gjatë dhe ndikimeve të kushteve klimatike. Personeli mjekësor i furnizon pacientët me analgjetikë, paracetamolë, antireumatikë, me preparate elementare etj.

Personeli mjekësor i Kryqit të Kuq mban evidencë të plotë për personat e trajtuar, sipas evidencës së tyre janë marrë këto të dhëna për periudhën kohore nga data 01.12.2015 deri në datën 09.12.2015.

Data e vizitës	01.12.2015	02.12.2015	03.12.2015	04.12.2015
Turni i parë	Janë vizituar gjithsej 26 persona	Janë vizituar 156 persona nga të cilët 27 fëmijë deri në moshën 10 vjeçare	Janë vizituar 43 persona nga të cilët 1 shtatzënë	Janë vizituar 107 nga të cilët 1 fëmijë dhe 1 shtatzënë
Turni i dytë	Janë vizituar gjithsej 57 persona, prej të cilëve 16 fëmijë deri në moshën 10 vjeçare	Janë vizituar 336 persona, nga të cilët 41 fëmijë dhe 7 shtatzëna	Janë vizituar 29 persona, nga të cilët 1 fëmijë	Janë vizituar 420 persona, nga të cilët 52 fëmijë dhe 5 shtatzëna

Data e vizitës	05.12.2015	06.12.2015	07.12.2015	08.12.2015	09.12.2015
Turni i parë	Janë vizituar 224 persona nga të cilët 35 fëmijë dhe 3 shtatzëna	Janë vizituar 120 persona, nga të cilët 17 fëmijë dhe 1 shtatzënë	Janë vizituar 106 persona, nga të cilët 8 fëmijë dhe 2 shtatzëna	Janë vizituar 176 persona, nga të cilët 39 fëmijë dhe 3 shtatzëna	Gjatë kohës së vizitës së Qendrës nga ana e AP, u vizituan gjithsej

Turni i dytë	Janë vizituar 100 persona, nga të cilët 10 fëmijë dhe 2 shtatzëna	Janë vizituar 248 persona, nga të cilët 55 fëmijë dhe 7 shtatzëna	Janë vizituar 79 persona, nga të cilët 1 fëmijë dhe 2 shtatzëna	Janë vizituar 60 persona nga të cilët 5 fëmijë	400 persona, nga të cilët 39 fëmijë.
--------------	---	---	---	--	--------------------------------------

Avokati i Popullit konstaton se për dallim nga Qendra e Pranimiit Transit “Vinojug”, një numër i madh i personave kanë kërkuar mbrojtje primare shëndetësore në Ambulancën në Tabanoc, si rezultat i qëndrimit të këtyre peronave në kushte joadekuate në Qendrën në Gjevgjeli.

Bisedë me migrantët

Gjatë vizitave, Avokati i Popullit – MPN zhvilloi më shumë biseda me migrantët dhe refugjatët, të cilët shprehën falënderim të posaçëm për aktivitetet e organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare. Ata u ankuan për kohën e humbur gjatë pranimit në pikën kufitare “Vinojug” – Gevgjeli dhe për kohën e pritjes së transportit në drejtim të pikës kufitare Tabanoc.

Më datë 10.12.2015, ekipi i Avokatit të Popullit dhe Mekanizmit Parandalues nacional hasi një grup migrantësh ekonomik prej 35 veta, të cilët kërkuan ndihmë sepse në pikën kufitare “Tabanoc” kishin qëndruar disa ditë dhe të njëjtët nuk janë lejuar të kalojnë në R. të Serbisë.

Avokati i Popullit për rastin e cekur bisedoi me policinë kufitare dhe me Drejtorin e Qendrës, me ç’rast u informua se migrantët nuk kishin kurrfarë dokumentesh, ndërsa gjatë kontrollit ishte konstatuar se nuk kishin qenë të regjistruar në pikën kufitare të Gjevgjelisë, e që sinjalizon se hyrja e tyre në territorin e Republikës së Maqedonisë është bërë përmes hyrjes ilegale dhe se bëhet fjalë për migrantë ekonomikë. Konform vendimit të përbashkët të vendeve të Ballkanit Perëndimor që të pranohen vetëm refugjatë nga Siria, Afganistani dhe Iraku, të njëjtëve nuk iu lejua kalimi në R. të Serbisë. Migrantëve iu ofrua të paraqesin qëllim për kërkimin e azilit, por këtë ata e refuzuan, kështu që mbetet vetëm të kthehen në territorin e R. të Greqisë. Pyetjes së

Avokatit të Popullit, se a është evidentuar refuzimi për paraqitjen e kërkesës për azil, iu përgjigjën se një lloj i këtillë i evidencës nuk mbahet.

KONSTATIME

1. Para hyrjes në Qendrën Transit “Vinojug”, është siguruar vetëm një tendë, në të cilën mund të vendoset një grup i vogël migrantësh/refugjatësh derisa kryhet kontrolli për hyrje, ndërsa të tjerët qëndrojnë jashtë në qiell të hapur dhe u ekspozohen kushteve të pavoritshme klimatike.

2. Ekziston sistem i dobët i evidentimit dhe regjistrimit të migrantëve/refugjatëve, i cili kryhet vetëm në bazë të dokumenteve të lëshuara nga R. e Greqisë. Nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë të nëpunësve policorë dhe personave refugjatë/migrantë, gjatë evidentimit të regjistrimit të tyre.

3. Gjatë hyrjes bëhet seleksionimi i refugjatëve dhe migrantëve ekonomikë sipas vendit të origjinës, pas çka personat-migrantë ekonomikë, edhe pse kanë hyrë në territorin e Republikës së Maqedonisë, kthehen prapa pa kurrfarë procedure.

4. Në hyrje të Qendrës së Përkohshme Transit “Vinojug” sistemi i sigurisë është i dobët dhe i paqëndrueshëm për kontrollin e refugjatëve/migrantëve dhe bagazhit të tyre, me përdorim të kohëpaskohshëm të skenerit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

5. Është i pamjaftueshëm bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të menaxherëve të qendrave të pranimit “Vinojug” dhe Tabanoc”, si dhe nuk është i përhershëm dhe gjithëpërfshirës koordinimi i organeve kompetente në Republikën e Greqisë, Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Serbisë sa i përket pranimit, trajtimit dhe transitit të refugjatëve/migrantëve.

6. Nuk janë përshtatur tërësisht objektet për pranimin e refugjatëve dhe migrantëve në kushte të dimrit, nuk është zgjidhur problemi me furnizimin me energji elektrike dhe nuk është siguruar ngrohja e të gjitha objekteve, ndërkohë që mungon edhe uji i nxehtë.

7. Nuk ka pranim human, gjithëpërfshirës dhe adekuat dhe as kujdes për grupet vulnerable, gjatë kohës së qëndrimit në Qendrën e Pranimit. Fëmijët, gratë, gratë shtatzëna, personat e moshuar dhe personat me invaliditet vendosen në objekte të cilat nuk janë të ngrohura dhe nuk u është siguruar ndihma përkatëse gjatë hyrjes dhe daljes nga Republika e Maqedonisë.

8. Transporti i refugjatëve/migrantëve është organizuar keq dhe pa nevojë mbahen gjatë në Qendër, paguajnë bileta me çmime të larta, ndërsa nuk kryhet as kategorizimi i çmimit për fëmijët mbi 10 vjet dhe personat me invaliditet. Refugjatëve dhe migrantëve nuk u mundësohet të zgjedhin se çfarë lloj transporti do të përdorin deri në "Tabanoc".

9. Në Qendrën e Përkohshme Transit "Vinojug" mënyra e ruajtjes dhe magazinimit të ushqimit është joadekuat, përkatësisht në qese plastmase e që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, ndërsa shpërndarja e tij për refugjatët dhe migrantët bëhet në mënyrë johumane. Gjithashtu, në Qendër nuk është siguruar racion i nxehtë.

10. Ndihma juridike në Qendrën e Pranimit "Vinojug" nuk është e plotë, veçanërisht mungon qasja gjithëpërfshirëse sa i përket detektimit të fëmijëve të pashoqëruar dhe pengimit që të njëjtët të shndërrohen në viktima të trafikimit me qenie njerëzore, ndërsa Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe organet e tjera kompetente dobët janë pranishme në terren.

11. Organizatat vendase dhe ndërkombëtare janë të pranishme në terren dhe u ofrojnë ndihmë dhe mbështetje refugjatëve/migrantëve. Mungon koordinimi më i madh me organet kompetente për mbrojtje më efikase.

REKOMANDIME

1. Të sigurohen kushte për pranim human të të gjithë personave të cilët presin për të hyrë në Qendrën e Përkohshme Transit “Vinojug” dhe të sigurohen më shumë objekte për këtë dedikim.

2. Të ndërmerren masa me qëllim të inkorporimit të mënyrës së re, më efikase dhe gjithëpërfshirëse të evidentimit dhe regjistrimit, përmes sistemit biometrik të evidentimit dhe fotografimit të këtyre personave.

3. Të mundësohet qasje joselektive dhe humane ndaj të gjithë personave të cilët kërkojnë ndihmë dhe mbrojtje, si dhe t’u mundësohet fillimi i procedurës përkatëse për njohjen e të drejtës së azilit ose qëndrimit të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë, ndërsa nëse personat e refuzojnë këtë të ekzistojë provë me shkrim për refuzimin e këtillë.

4. Përmirësim i kontrolleve të sigurisë, përmes kontrollit të rregullt me përdorimin e vazhdueshëm të skenerëve për kontrollin e bagazhit dhe personave, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

5. Të vendoset koordinim më i mirë dhe më intensiv i menaxherëve të qendrave të pranimit në nivel shtetëror dhe ndërshtetëror, si dhe bashkëpunim midis shërbimeve policore kufitare të Republikës së Greqisë - Republikës së Maqedonisë-Republikës së Serbisë për pranimin dhe transitimin me kohë, human dhe të plotë të refugjatëve dhe migrantëve.

6. Urgjentisht të merren masa për sigurimin e të gjitha kushteve për pranimin e refugjatëve/migrantëve në kushte dimërore, furnizimin me energji elektrike me tension të nevojshëm, me qëllim të ngrohjes adekuate të objekteve dhe sigurimit të ujit të nxehtë për refugjatët dhe migrantët.

7. Të merren masa për pranim human, kujdes dhe trajtim human të personave vulnerabil në Qendrën e Pranimit. Për gratë, fëmijët, gratë shtatzëna, personat e moshuar dhe personat me nevoja të veçanta të organizohet transporti përmes pikave legale kufitare.

8. Transporti i refugjatëve/migrantëve të organizohet pa ndërprerje dhe pa pritje të panevojshme prej shumë orësh, me respektimin e të drejtës së përzgjedhjes së llojit të mjetit transportues, si dhe të ndërmerren masa për barazimin e çmimit të biletave, në përputhje me parimin e barazisë së qytetarëve ndaj shërbimeve.

9. Të ndërmerren masa për ruajtjen dhe magazinimin e ushqimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe masa për sigurimin e detyrueshëm të ushqimit të nxehtë, ndërsa ushqimi të shpërndahet në mënyrë humane me sigurimin e kushteve modeste për konsumimin e tij.

10. Organizim më i mirë i ndihmës juridike në qendrat e pranimit, prezencë më e madhe e organeve dhe institucioneve dhe sigurim i përhershëm i personave profesionistë (punonjës social, psikologë, pedagogë), të cilët do të ofrojnë ndihmë përkatëse profesionale dhe mbrojtje për fëmijët, grupet vulnerable dhe të gjithë personat të cilët do të kenë nevojë për këtë.

11. Të vendoset dhe përforcohet bashkëpunimi dhe koordinimi me organizatat joqeveritare vendase dhe ndërkombëtare, të cilat punojnë në çështjen e refugjatëve/migrantëve.

AVOKAT I POPULLIT

Ixhet Memeti